



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. 640/13 Prot.

Tiranë, më 30/09/2017

V E N D I M

Nr. 134, Datë 30.09.2017

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS TIRANË "MBI
PËRPUTHSHMËRINË DHE RREGULLSHMËRINË FINANCIARE"
për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2016.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25, dhe 30 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Degës së Doganës Tiranë, me kriteret dhe kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi", sipas programit të auditimit nr. 640/1 prot., datë 23.06.2017, i ndryshuar me nr. 640/2 prot., datë 07.08.2017, për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri më datë 31.12.2016.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100¹) e të ardhurave dhe shpenzimeve. Sipas ISSAI 4100, objektivi i audituesve në një auditim rregullshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë, është në përputhje në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Nga auditimi mbi rregullshmërinë, sa i takon shkallës së ndjekjes nga subjekti Dega e Doganës Tiranë, të rregullave, ligjeve, rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u konstatuan devijime materiale në drejtimit e mëposhtme:

Treguesit e performancës së Degës Doganore Tiranë nuk janë në nivele pozitive, ku treguesi i saj kryesor “të ardhurat” gjatë periudhës së audituar paraqitet me mosrealizim. Nga analiza sipas strukturës së të ardhurave rezultoi me mosrealizim zëri “akciza” me diferencë në vlerë minus 1,035,795 mijë lekë ose në masën 92 %, dhe zëri “renta minerare” me diferencë në vlerë minus 96,089 mijë lekë, ose në masën 1.02%.

Treguesit e borxhit doganor janë në shifra jashtëzakonisht të larta ku për vitin 2016 borxhi reflekton një rritje në total në shumën **447,555,052 lekë** ose në masën **9.6%**. Ecuria e arkëtimit të tij është tepër e ulët

Sistemi i vlerësimit doganor ka patur mangësi në drejtim të plotësimit të dokumentacionit që shoqëron praktikën doganore për rastet e aplikimit të metodës së transaksionit; mangësi në qëndrimin që duhet të mbajë dogana në rastet e parregullsive të dokumentacionit të detyrueshëm për vërtetimin e origjinës preferenciale (deklaratë faturë) në bazë të së cilit subjekti përfiton nga tarifatat preferenciale; të moslogaritjes së shpenzimeve të transportit në kushtet e lëvrimin në inkotermin “EXW” me metodën e të dhënave të disponueshme. Nga monitorimi i praktikave doganore në sistemin Asycuda World rezultoi se, në shumicën e rasteve nga personeli përpunues doganor nuk janë kryer procedurat e marrjes së mostrave edhe pse nga profili i analizës së Riskut në DPD është vendosë kriteri i detyrueshëm i “Marrjes së Mostrave dhe dërgimi i tyre për mostrim pranë Laboratorit Kimik Doganor”. Nga sa më sipër rezultoi efekt financiar negativ në shumën totale **545,299,744 lekë**.

Sistemi i funksionimit dhe i mbikëqyrjes së regjimeve të përpunimit aktiv/pasiv në përgjithësi ofron siguri, por ka mangësi si në drejtim të organizimit të punës, të mbikëqyrjes së subjekteve ashtu edhe në administrimin e dokumentacionit si mosndjekje të procedurave të asgjësimit të mbetjeve dhe mosdokumentim të këtij procesi; mosparaqitja pranë Degës Doganore e materialit të mbylljes së regjimit. Nga sa më sipër rezultoi efekt financiar negativ në shumën totale **232,841,193 lekë**.

Konkluzion/Opinion

Nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Dega e Doganës Tiranë, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, efektet e të cilave justifikojnë **dhënien e një opinionit të kualifikuar²**.

¹ **ISSAI 4100** – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta

² **Opinion i kualifikuar** - Audituesi shpreh një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të ose rastet e mospërputhjes, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se 60 % e borxhit doganor gjendje në fund të vitit 2016 është mbështetur nga Autoriteti Gjyqësor Tiranë me urdhra ekzekutimi në vlerën 2,784,294 mijë lekë, veprim i cili deri këtu tregon për punën jo të mirë që ka bërë Zyra e Borxhit Doganor. Niveli i arkëtimit të borxhit paraqitet shumë i ulët, duke treguar për punën e pamjaftueshme që kanë bërë strukturat e specializuara të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe strukturat e tjera të shtetit të ngarkuara me ligj për të mbështetur rikuperimin e borxhit doganor. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 106-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 1.1. Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrin masa konkrete, për të zgjidhur problemet që pengojnë rikuperimin e borxhit doganor në vlerën **4,644,448** mijë lekë, duke angazhuar të gjitha strukturat e specializuara për të zbatuar hap pas hapi kërkesat e legjislacionit doganor nëpërmjet një programi të posaçëm, për vendosjen e sekuestrove ekzekutive për të gjithë ato subjekte që rezultojnë në gjendje debitorë në vlera të mëdha.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar të praktikave doganore lidhur me vlerësimin doganor të mallrave të kapitullit *02* të Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave, rezultuan mallra me origjinë nga vendet jashtë Bashkimit Evropian (NEU) apo nga vendet e Bashkimit Evropian (EU), të cilët janë deklaruar me 20 % (apo më pak), të çmimit krahasuar me të dhënat e disponueshme apo importet dhe deklarimet e kryera nga vetë subjektet apo subjekte të tjerë në këtë degë apo në degë të tjera doganore në periudhat e mëparshme apo fillim vitin. Këto praktika doganore nga sektori i vlerës, janë trajtuar me transaksion, duke u mbështetur në shkresat **nr. 1945 prot., datë 25.01.2016** dhe **nr. 2344 prot., datë 28.01.2016** të DPD lidhur me vlerësimin doganor të artikujve të mishit, veprime këto, jo në përputhje dhe shkelje të kërkesave të nenit 33-37 të Kodit Doganor si dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë së Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore... dosjes së të dhënave të disponueshme për shpenzimet e transportit”. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 20-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 2.1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të shfuqizojë shkresat **nr. 1945 prot., datë 25.01.2016** dhe **nr. 2344 prot., datë 28.01.2016** të DPD, lidhur me vlerësimin doganor të mallrave të kapitullit *02* të Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave, të cilat bien ndesh me kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë së Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore... dosjes së të dhënave të disponueshme për shpenzimet e transportit...”.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i ushtruar në Degën e Doganës Tiranë u konstatua se, në disa praktika doganore nuk janë marrë mostrat, edhe pse nga profili i analizës së Riskut në DPD është vendosur si kriter i detyrueshëm marrja e mostrave dhe dërgimi i tyre për mostrim pranë Laboratorit Kimik Doganor, me qëllim përcaktimin e saktë të kodit tarifor të këtyre mallrave. Nga personeli përpunues i praktikave doganore është vepruar në kundërshtim me “Udhëzimin Praktik të Analizës së Riskut”, të përcaktuara në kërkesat e nenit 15, pika 13 e Rregullores së Brendshme

të degëve doganore nr. 19095/2 prot, datë 12.11.2012. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 20-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 3.1. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë nëpërmjet specialistit të analizës së riskut dhe specialistit të aposteriorit të kontrollojnë nëpërmjet sistemit “Asycuda World”, të gjitha rastet e praktikave doganore për të cilat është kërkuar marrja e mostrave për arsye të analizimit dhe përcaktimit nga Laboratori Kimik Doganor i Klasifikimit Tarifor të Mallrave dhe të rakordojnë me regjistrin e marrjes së mostrave. Në përfundim të përgatitet një raport për fenomenin e konstatuar dhe të përcillet të Kryetari i degës doganore, i cili duhet të dalë me një akt administrativ për përmirësimin e punës në të ardhmen për të mos lejuar përsëritjen e këtij fenomeni i cili mund të sjellë edhe efekte financiare.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i ushtruar në Degën e Doganës Tiranë u konstatua se, në disa praktika doganore, elementët e deklarimit që lidhen me raportin e peshës bruto/neto rezultojnë me koeficient tepër të lartë, në **nivel 46%-75% ambalazh**. Nga personeli përpunues i kontrollit dokumentar dhe fizik nuk janë kryer veprime verifikuese dhe kontrolluese me qëllim kontrollin e plotë sasior të mallit të deklaruar për qëllime taksimi, në kundërshtim me kërkesat e nenit 71 të Kodit Doganor “Kontrolli i mallrave dhe mjeteve”. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 20-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 4.1. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë të marrë masa që personeli përpunues doganor i kontrollit dokumentar dhe fizik në të gjitha rastet e praktikave doganor ku elementët e deklarimit doganor që lidhen me raportin e peshës bruto/neto rezultojnë me koeficient tepër të lartë **ambalazhi**, të ndërhyjë duke e kanalizuar praktikën doganore në kanal të kuq për kontroll të plotë fizik, pasi ky lloj devijimi në rastet e aplikimit të metodës së vlerësimit doganor me indikatorët e peshës mund të mbartë edhe efekte negative financiare.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi rezulton se disa operatorë ekonomik që operojnë në fushën e akcizës me status depozitues të miratuar, nuk kanë kryer kalibrime për të gjitha depozitat dhe silloset me kapacitet mbajtës mbi 10 hektolitra, nuk disponojnë kalimatësat në hyrje/dalje e depozitave dhe në pikën e shitjes, në kundërshtim me procedurën ligjore të shprehur në pikën 3/c, neni 20 të ligji nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të përcaktuara si “Detyrime të Depozituesit të Miratuar” për një mbikëqyrje sa më të plotë të magazinave fiskale. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 124-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 5.1. Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me qëllim rregullimin e situatës së krijuar të kryejë kontrole për të gjithë operatorët me status të depozituesit të miratuar dhe në rastet e shkeljeve të konstatuara të aplikojë sanksione administrative dhe tu kërkojë operatorëve kalibrimin e gjithë depozitave, enëve, sillosëve si dhe vendosjen e kalimatësave në hyrje/dalje e depozitave dhe në pikën e shitjes.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi konstatohet se operatorë ekonomikë që operojnë në fushën e regjimeve ekonomike të tipit FASON nuk i kanë dhënë destinacion brenda afateve të përcaktuara në autorizim, mallrave të natyrës fustela, forma kallëpe të cilat janë pjesë integrale e domosdoshme

e procesit të prodhimit gjatë aktivitetit tregtar, veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 157, 164, 271 dhe 273 të ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 83-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 6.1. Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Departamentin Teknik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të ngrejë grupe pune të përbashkëta, me qëllim rregullimin e menjëhershëm të situatës së krijuar për këto sasi mallrash të importuara sipas autorizimeve të tipit RLP, duke shtyrë afatin e autorizimeve të RLP ose tu japë një destinacion të ri doganor.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve lidhur me shpërblimin e dëmit është zbatuar pjesërisht rekomandimi nr. 4 si dhe anekset nr. 6 – 11 të rekomandimit nr. 1, të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit të mëparshëm. Rezulton se Dega e Doganës Tiranë ka dalë me vendime administrative në total për vlerën 255,239 mijë lekë ose 66.5 % të vlerës së rekomanduar. (Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 12-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 7.1. Drejtorja e Përgjithshme e Doganave të marrë masa për ndjekjen e praktikave që mundësojnë zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në vlerën **66,051 mijë lekë** përmes verifikimeve doganore pranë Autoriteteve Doganore Homologe për praktikat doganore që lidhen me rekomandimet e lëna në Anekset nr. 6-11 të rekomandimit nr. 1 dhe rekomandimi nr. 4, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dërguar me shkresën nr. 544/8 prot, datë 20.09.2016.

Nga Auditimi i Brendshëm i DPD, të analizohet përgjegjësia institucionale për zvarritjen e përgjigjeve që do të mundësonin arkëtimin në buxhet të shumave të konstatuara si shmangie të detyrimeve doganore

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PER SHPERBLIM DEMI

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Dega e Doganës Tiranë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **në vlerën 799,874,081 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar dhe procedurave të ndjekura lidhur me deklarimin e mallrave, rezultuan raste të: trajtimit me origjinë preferenciale të artikujve me deklarata faturë, vlera e të cilëve e kalon 6000 euro; keqklasifikimit të artikujve; shqyrtim jo si duhet i vlerës doganore të mallrave dhe transportit si dhe jo konfiskim të mallrave për sasi të cilat kanë rezultuar më tepër gjatë verifikimit të sasisë së deklaruar, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e neneve 34-37, 256.2, 256.4, 261.1, 261.2 dhe 261.3 të Kodit Doganor si dhe Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore...”, nxjerrë për këtë qëllim. (Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 20-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 1.1. Dega e Doganës Tiranë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera

në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën **421,215,297 lekë** nga subjektet sipas anekseve nr. 1-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më 31.12.2017

2. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar, praktikave doganore të përzgjedhura të subjekteve të cilët kanë operuar në kushtet e autorizimeve të Magazinave Doganore me kodin e procedurës *4071*, nga ana e sektorit të regjimeve, praktikat doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky, jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor, i ndryshuar pasi dokumentacioni bashkëlidhur praktikave doganore nuk i plotëson kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme..”, nxjerrë për këtë qëllim. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 78-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 2.1. Dega e Doganës Tiranë të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **245 raste/subjekte**, në vlerën **125,084,447 lekë** nga subjektet sipas anekseve nr. 55-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më 31.12.2017

3. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të marra për shkeljet në fushën doganore rezultuan vendimeve administrative të nxjerra jo në përputhje me përcaktimet e nenit 231, 256, 261, 286, 287 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, ligjit nr 61 /2012 “Për Akcizat në RSH”, jo në përputhje me Udhëzimin nr. 2665 prot, datë 09.02.2011 të DPD, jo në përputhje me Udhëzimin nr. 8 datë 30.12.2013 “Për zbatimin praktik të taksës së ambalazhit” i nxjerrë në zbatim të Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar, në shumën totale 19,829,752 lekë për 12 raste subjektsh për vendime të nxjerra gjatë vitit ushtrimor 2016. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 110-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 3.1. Dega Doganore Tiranë të kërkojë ndryshimin ose revokimin në rrugë ligjore për vendime administrative në shumën totale **19,829,752 lekë për 12 raste subjektsh** duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim nxjerrjen dhe arkëtimin e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore nga 12 operatorë tregtare bazuar në ligjin nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjin nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSH” i ndryshuar, sipas aneksit nr. 63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më 31.12.2017

4. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi procedurave doganore gjatë mbikëqyrjes së regjimeve doganore ekonomike rezultuan veprime që kanë sjelle pasoja në respektim afateve të regjimeve doganore të përpunimit aktiv, tejkalim i afateve të përcaktuara në autorizimet e regjimet e lejimit të përkohshëm veprime këto jo në përputhje me kërkesat e nenit 157, 164, 271 dhe 273 të ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimit nr. 1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”, me zhdoganime mallrash nga regjimet e tipit RPA jo në përputhje me shpjegimet dhe përcaktimet Pikës 4 të Sesionit I të Udhëzimit nr 25 datë 30.11.2007 “Për Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore”, nenit 64 pika 1,b e VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, neni 54,

titulli VI "Vlera Doganore" pika c, e VKM nr. 205 datë 13.04.1999 "Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor" i ndryshuar dhe nenit 35 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, që lidhen me veprimtarinë e operatorëve ekonomike për periudhën e juridiksionit të auditimit në shumën totale 232,841,193 lekë. (Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 83-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 4.1. Dega Doganore Tiranë të ndjekë arkëtimin e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore në **shumën 232,841,193 lekë** për shkelje doganore të kryera nga operatorë të tregtar për veprime të kryera në kundërshtim dhe tejkalim të afateve administrative gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RPA, RLP dhe hedhjes në qarkullim të lirë mallrave të importuara më parë nën regjimin RPA dhe RLP duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, me qëllim arkëtimin e detyrimeve dhe sanksioneve doganore sipas anekseve nr. 62-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit .

Deri më 31.12.2017

5. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit për procedurat e doganore të subjekteve që operojnë sipas Ligjit nr. 61 datë 24.05.2012 "Për Akcizat në RSH" u konstatuan veprime të kryera jo në përputhje me gërmën (c) të pikës 3, neni 20 dhe 85 të ligjit nr. 61 datë 24.05.2012 për "Akcizat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe veprime jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 71/2014 të ndryshuar dhe ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre" i ndryshuar, neni 12, pika (2), shkronja (a) "Inspektorati shtetëror përgjegjës ka të drejtë dhe përgjigjet për kontrollin e zbatimit të normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, miratimin e kartave teknologjike të impianteve dhe instalimeve përkatëse", me Manualin Praktik nr. 13048 prot, datë 20.05.2016 për "Përdorimin e modulit të Akcizës EMCS në sistemin informativ për depozituesit e miratuar që prodhojnë dhe përpunojnë apo stokojnë produkte energjetike " në shumën **1,211,112 lekë për 24 raste** subjektsh. (Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 124-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 5.1 Dega Doganore Tiranë të nxjerrë dhe arkëtojë në rrugë ligjore detyrimin doganor dhe gjobat doganore të akcizës në shumën **totale 1,211,112 lekë për 24 raste** subjekte që operojnë sipas ligjit nr. 61 datë 24.05.2012 për "Akcizat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, sipas aneksit nr. 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit me qëllim arkëtimin e shumës së rekomanduar.

Deri më 31.12.2017

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", për shkak të ristrukturimit të deklaruar në programin qeverisës nga Kryeministri, mbi bashkimin e dy institucioneve kryesore të administrimit të të ardhurave, i rekomandojmë Kryetarit të Degës së Doganës Tiranë që në vlerësim të shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, pasi të bëjë klasifikimin e tyre, sipas pikës 1, germa "b", "c" dhe "ç" të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin

e procedurave për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R